

Takimi i tretë online i Projektit Erasmus+ CBHE SINCERE

Më 5 janar 2026, u zhvillua takimi i tretë online i konsorciumit të projektit Erasmus+ CBHE **SINCERE** – **“Strengthening Integrity and Ethical Culture in Regional Higher Education”**, nën drejtimin e koordinatorit të projektit, Universiteti I Korçës (UNIKO).

Konsorciumi SINCERE përbëhet nga nëntë institucione partnere: pesë institucione të arsimit të lartë nga Shqipëria dhe Kosova, katër institucione nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, si dhe një institucion nga një vend i asociuar me programin Erasmus+.

Takimi u fokusua në zbatimin e veprimtarisë WP2.1 – Ngritja e Task Forcës mbi Integritetin Akademik (TFAI). Në kuadër të kësaj veprimtarie, u raportua mbi ndjekjen e procedurave institucionale për krijimin e Task Forcës në pesë institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri dhe Kosovë, në përputhje me mekanizmat e brendshëm të vendimmarrjes.

Task Forca mbi Integritetin Akademik (TFAI) ka për mision të:

- mbështesë zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës së Integritetit Akademik;
- promovojë parimet e ndershmërisë, etikës dhe përgjegjësisë akademike;
- ndihmojë strukturat akademike dhe administrative në parandalimin dhe trajtimin e shkeljeve të integritetit akademik.

Universiteti “Eqrem Çabej” është institucioni përgjegjës për këtë veprimtari, e planifikuar në Paketën e Dytë të Punës (WP2.1).

Projekti SINCERE bashkon institucione të arsimit të lartë nga Shqipëria, Kosova dhe vendet e BE-së, me synim forcimin e kulturës së integritetit dhe etikës akademike në arsimin e lartë.

